



Breaking News:

DVP Durrës, gjatë 24 orëve të fundit



LajmetOperacionet

27/02/2025

Tiranë/Finalizohet Operacioni Policor “Pasagjeri”

Tiranë/Finalizohet operacioni policor “Pasagjeri”.

Lëvizte me taksì, i armatosur me pistoletë dhe me thikë, arrestohet në flagrancë 32-vjeçari.

I arrestuari, shtetas me precedent për krime kundër jetës.

Sekuestrohen arma e zjarrit me municion, mjeti prerës dhe shuma parash në lekë dhe në euro, që iu gjetën 32-vjeçarit, në çantë.

Shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, pas sigurimit të informacionit se një shtetas me precedent kriminal, lëvizte i armatosur, me taksì, për të shmangur kontrollet e Policisë, kanë ndërhyrë menjëherë për ta kapur dhe vënë në pranga.

Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe profesionale operacionale, të kryera në kuadër të operacionit “Pasagjeri”, u ndalua në rrugën “Mysym Keta”, taksia me të cilën lëvizte shtetasi A. Ç., 32 vjeç. Nga kontrollet, iu gjetën në çantë, 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak, 1 mjet prerës (thikë), 9900 euro dhe 250 000 lekë.

Në përfundim të veprimeve procedurale, 32-vjeçari u arrestua në flagrancë për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, si dhe materialet iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)